



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025

Nr: 123

Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 25 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Agron Malaj**
Kryetar për Bashkinë Mat

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator nëpërmjet miratimit të akteve të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për një kategori të caktuar personash nga Bashkia Mat

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 25 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Këshilli i Bashkisë Mat është mbledhur më datë 07.02.2005 ora 10:00 dhe ka miratuar rendin e ditës me këto pika:

- *Miratimin e rendit të ditës;*

Data: 20.02.2025

Nr: 123
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 25 ID datë 18.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike/PD”

- *Shqyrtim dhe miratim i numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025;*
- *Shqyrtim dhe miratim i pagave të punonjësve të Bashkisë Mat për vitin 2025;*
- *Shqyrtim dhe miratim i përfituesve të programit të strehimit “Subvencion i qirasë” për 32 familje në nevojë;*
- *Të ndryshme.*

Mbështetja, promovimi dhe miratimi i akteve me karakter social të cilat synojnë dhënien e ndihmave për një kategori të caktuar personash është veprimtari publike e ndaluar sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.”

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Agron Malaj, Kryetar për Bashkinë Mat.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI